



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

**DOKUMENTET E NEVOJSHEM PER LESHIMIN E
DEKLATARES SE VLEFSHMERISE PER PARASHTRIMIN E KERKESES PER
NJOHJEN E TITULLIT TE STUDIMIT NE ITALI**

Personat e interesuar për lëshimin e kësaj deklarate konsullore duhet të caktojnë një takim sipas mënyrave që Ambasada Italiane në Prishtinë ka përcaktuar.

Për marrjen e dokumentit të kërkuar, aplikuesi duhet të dorëzojë pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë dokumentet e mëposhtëm:

A) **KERKESEN** për lëshimin e deklaratës së vlefshmërisë të nënshkruar nga personi i autorizuar si edhe një **fotokopje të qartë të pasaportës** së këtij/kësaj të fundit; është shumë e rëndësishme që në kërkesën në fjalë të shënohet edhe përdorimi I dokumentit në Itali., në mungesë të këtij saktësimi, kërkesa nuk do të mund të procesohet.

B) **Fotokopje të letërnjoftimit personal;**

KUJDES: modeli i kërkesës së lartpërmendur mund të shkarkohet nga portal elektronik zyrtar i Ambasadës Italiane në Prishtinë në adresën:
http://www.ambpristina.esteri.it/Ambasciata_Pristina/Menu/Informazioni_e_servizi/Servizi_consolari/Dichiarazioni_di_Valore/

KUJDES: Për të interesuarit që jetojnë rregullisht në Itali dokumenteve të lartpërmendur duhet t'i bashkangjitet edhe një **fotokopje e qartë e Lejes së Qëndrimit (Permesso di Soggiorno)** të lëshuar nga Komisariati Qendror i Policisë në provincën e vendbanimit (*Questura*);

C) DOKUMENTET SHKOLLORE OSE AKADEMIKE PERKATESE

C1) në rast se i/e interesuari/a ka mbaruar shkollën fillore:

Certifikata e notave e Shkollës Fillore (origjinal dhe e fotokopjuar) e legalizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; dokumente shkollore të fotokopjuara duhet t'i bashkangjitet përkthimi origjinal në gjuhën italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë;

C2) në rast se i/e interesuari/a ka mbaruar shkollën e mesme:

- **Diploma origjinal dhe fotokopje** si edhe **dëftesat e marra gjatë cdo viti studimi (original dhe fotokopje):** dokumentet e lartpërmendur duhet të jenë të legalizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; dokumenteve shkollore të fotokopjuara duhet t'i bashkangjitet përkthimi origjinal në gjuhën italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë;

C3) në rast se i/e interesuari/a ka mbaruar studimet e larta (Universitetin apo Institute të tjera të larta akademike):

-**Diploma e Universitetit në original dhe fotokopje** si edhe **Pasqyra (Transkripti) i notave origjinal):** – dokumentet e lartpërmendur duhet të jenë të legalizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si edhe të përkthyer në gjuhën italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga Ambasada Italiane në Prishtinë.



**Ambasciata d'Italia
Pristina**

**LISTA E PERKTHYESVE GJYQESORE TE NJOHUR NGA AMBASADA ITALIANE
PRISHTINE**

| | | | | | |
|----------------------|-------------|-----------------|-------------|----------------|-------------|
| Prof. Dr. Gani Hoxha | 044 115 496 | Donjetë Berisha | 044 233 173 | Shaban Hoxha | 049 194 461 |
| Oliver Sedaj | 044 159564 | Isak Hoxha | 044 117 725 | Valentin Gecaj | 044 189 678 |
| Denida Berisha | 044 971 325 | Hysni Pukaj | 044 895 111 | Nikollë Markaj | 044 126 827 |
| Teuta Kurshumlija | 044 309 338 | Fatos Shala | 044 253 675 | | |

KUJDES: Qoftë vendosja e titujve akademikë përpara emrave, që përbën një të drejtë të përkthyesit, si edhe renditja e tyre nuk shprehin, në asnjë mënyrë, asnjë lloj preferencë zgjedhjeje nga ana e kësaj Ambasade.

Ju përkujtojmë që përkthyesit gjyqësore nuk kanë asnjë raport pune me Ambasadën dhe nuk përfaqësojnë autoritetin e saj institucional. Në rast se gjatë përkthimit të dokumenteve hasni në parregullsi nga ana e përkthyesve jeni të lutur që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të informoni me shkrim këtë Ambasadë.

D) certifikata e martesës e legalizuar nga Departamenti i Gjendjes Civile-Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë si edhe e përkthyer në gjuhën italiane nga një përkthyes gjyqësor i njohur nga kjo Ambasadë VETEM në rast se i/e interesuar/a ka ndryshuar mbiemrin pas martesës.

E) PAGESA E TARIFAVE KONSULLORE

Tarifat konsullore të aplikuara janë si më poshtë vijon:

- 34.00 EURO PER CDO DOKUMENT

(legalizimi i dokumentit 17.00 Euro + legalizimi i nënshkrimit të përkthyesit 17.00 Euro)

KUJDES: pagesa bëhet vetëm në momentin e pranimit të dokumenteve pranë Ambasadës Italiane dhe personat e interesuar janë të lutur që të paguajnë, nëse është e mundur, shumën e saktë të tarifave konsullore të parashikuara.

F) TËRHEQJA E DOKUMENTEVE

Pas përfundimit të procedurës, Zyra Konsullore pranë Ambasadës Italiane në Prishtinë do të kontaktojë personin e interesuar për dorëzimin e dokumenteve. Kohëzgjatja e procesimit të kërkesës varet nga ngarkesa e zyrës si edhe nga marrja e përgjigjeve nga ana e institucioneve të ndryshme italiane dhe vendore lidhur me verifikimet e ndërmarra.

Është e drejtë e Ambasadës që të kërkojë, në rast se është e nevojshme apo kërkohet nga institucione të tjera, edhe dokumente shtesë të cilat do t'ju kërkohen me shkrim nga ana e përgjegjësit të procedurës administrative.

AMBASADA ITALIANE NE PRISHTINE